

## LEGALIZIMI DHE APOSTILIMI I DOKUMENTEVE

+-

### ***I. LEGALIZIMI DHE APOSTILIMI I DOKUMENTEVE***

Të gjithë dokumentet e lëshuara nga administrata shqiptare e të destinuara për t'u përdorur jashtë shtetit duhet të jenë të legalizuara. Të legalizuara duhet të jenë edhe dokumentet e huaja që do të paraqiten në autoritetet tona.

### ***II. LEGALIZIMI I DOKUMENTEVE NË PËRFAQËSITË TONA DHE NË MEPJ***

Legalizimi është procedura e njohjes së rregullshmërisë së dokumentit të huaj. Për këtë diplomatët konsullorë konfirmojnë funksionarin përgjegjës dhe institucionin, përkatësisht duke vërtetuar nënshkrimin dhe vulën. Më parë autoriteti që lëshon dokumentin duhet të ketë njoftuar personat që kanë të drejtë të lëshojnë dokumente dhe depozituar nënshkrimet e tyre.

Autoritetet përgjegjëse për legalizimin e dokumenteve për secilin vend të huaj mund të gjenden në faqet zyrtare të ministrive të jashtme.

Legalizimi i dokumenteve shqiptare për përdorim jashtë shtetit dhe legalizimi i dokumenteve të huaja për tu paraqitur në autoritetet shqiptare rregullohet me VKM nr. 134, datë 07.03.2003.

#### **Bashkëlidhur:**

Lista e vendeve, për të cilat kërkohet legalizimi i dokumenteve: [Lista e vendeve me legalizim](#)

### ***III. APOSTILIMI I DOKUMENTEVE***

Shqipëria është anëtare e Konventës së Hagës “Për heqjen e detyrimit të legalizimit të dokumenteve zyrtare të huaja” të 5 tetorit 1961, që do të thotë se dokumentet shqiptare që do të përdoren në vendet anëtare të së njëjtës Konventë, si dhe anasjelltas, nuk do të legalizohen nga përfaqësitë diplomatike e konsullore. Për më shumë:

[http://www.hcch.net/index\\_en.php?act=conventions.authorities&cid=41](http://www.hcch.net/index_en.php?act=conventions.authorities&cid=41)

Në bazë të kësaj Konvente, dokumentet pajisen me një vulë Apostille nga autoriteti kompetent i vendit ku janë lëshuar dhe më pas mund të përdoren direkt në institucionin përkatës (Gjendje civile, gjykatë, institucion arsimor, etj.) të vendit pritës.

Autoritetet përgjegjëse për apostilimin e dokumenteve gjenden në adresën:

[http://www.hcch.net/index\\_en.php?act=conventions.authorities&cid=41](http://www.hcch.net/index_en.php?act=conventions.authorities&cid=41)

#### **Bashkëlidhur:**

Lista e vendeve, për të cilat kërkohet apostilimi i dokumenteve: [Lista e vendeve me apostilim](#)

Bazuar në marrëveshjet me autoritetet e vendeve respektive Itali, Belgjikë, Austri, Kuvajt përkthimi/noterizimi i dokumentave në vend, në gjuhën e shtetit ku do të përdoret merret i mirëqenë pas legalizim/apostilimit nga MEPJ.

### ***IV. VENDET PËR TË CILAT NUK KËRKOHET LEGALIZIMI/APOSTILIMI I DOKUMENTEVE***

Me marrëveshje reciproke vendet e listës si më poshtë janë të përjashtuara nga detyrimi i legalizimit ose apostilimit paraprak të dokumenteve. Autoritetet shqiptare pranojnë dokumentet e këtyre vendeve pa formalitete të tjera: - Hungari- Republika Çeke- Rumani- Rusi- Bullgari- Kosovë

#### **Institucionet përgjegjëse**

Në Shqipëri, autoriteti përgjegjës për legalizimin e apostilimin e dokumenteve është MPJ, Drejtoria Konsullore. Në vende të tjera mund të jetë Ministria e jashtme, Ministria e Drejtësisë, apo edhe struktura të ndryshme lokale.

Autoritetet përgjegjëse për legalizimin e dokumenteve për secilin vend të huaj mund të gjenden në faqet zyrtare të ministrive të jashtme.

Autoritetet përgjegjëse për apostilimin e dokumenteve gjenden në adresën:

[http://www.hcch.net/index\\_en.php?act=conventions.authorities&cid=41](http://www.hcch.net/index_en.php?act=conventions.authorities&cid=41)

## ***V. PARAQITJA E DOKUMENTEVE PËR LEGALIZIM***

Paraqitja e dokumenteve për legalizim jashtë shtetit bëhet nëpërmjet aplikimit online në platformën SHKO/e-albania pranë Misionit Diplomatik dhe Postit Konsullor të RSH-së jashtë

Paraqitja e dokumenteve për legalizim në Shqipëri bëhet përmes shërbimeve postare.

Për më shumë:

- [Legalizimi i dokumenteve të huaja;](#)
- [Apostillimi i dokumenteve;](#)
- [Legalizimi i dokumenteve shqiptare;](#)